



**VENDIM**

**Nr. 58, Datë 29.04.2016**

**MBI  
FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENSIMIN E SHOQËRISË  
“DAAB ENERGY GROUP” SH.P.K NË AKTIVITETIN E  
TREGËTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2 gërma “d” dhe 110 të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, neneve 4, pika 1, gërma “g”; 5, pika 2; 10 pika 3 të “Rregullores për Procedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, Nr. 108, datë 09.09.2008 dhe nenit 18 pika 1 gërma “a” e Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21 datë 18.03.2009, te ndryshuar, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 29.04.2016, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Daab Energy Group” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut për liçensimin në aktivitetin e tregëtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie;

**Konstatohet se :**

Aplikimi i shoqërisë “Daab Energy Group” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/ të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave” si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, gërma ‘a’, ‘b’ dhe ‘c’) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërma ‘a’, ‘b’, ‘c’, ‘d’, ‘e’)) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gërma ‘a’, ‘b’, ‘d’) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Të dhënat specifike të liçensës (neni 9, pikat 4/10 gërma ‘c’) janë plotësuar në mënyrë korrekte.

**Për mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:**

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3 gërma ‘c’)
- Të dhënat specifike të liçensës (neni 9, pikat 4/10 gërma ‘a’ dhe ‘b’)

do të njoftohet subjekti që në bazë të “Rregullores për Proçedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/të Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, neni 10, pika 10 dhe neni 11, pika 1, t’i paraqesë këto në ERE, brenda afateve të përcaktuara.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të fillojë procedurat për licensimin e shoqërisë “Daab Energy Group” sh.p.k., në aktivitetin e tregëtimit të energjisë elektrike,
2. Drejtoria e Liçensimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licensuarve të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë  
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-s**  
**Petrit AHMETI**